



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Mbarimi i shkollimit me sistem të vjetër arsimor

NUMËR: 13/2009

DATË: 09.06.2009

Në mbështetje të neneve 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 42.1 të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë , nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1
Qëllimi

- 1 Me këtë UA përcaktohet e drejta, afatet dhe shkolla në të cilën nxënësi mund t'a përfundojë shkollën e mesme me sistem të vjetër arsimor.

Neni 2
E drejta e nënshtrimit të provimeve

1. Të drejtë për t'iu nënshtruar provimeve kanë vetëm ata nxënës të cilët nuk e kanë përfunduar vitin e fundit dhe provimin e diplomës.

Neni 3
Shkolla ku nxënësi u nënshtrohet provimeve

1. Nxënësi duhet t`u nënshtrohet provimeve në shkollën përkatëse, aty ku e ka ndërprerë shkollimin.

Neni 4
Afatet

1. Për ta përfunduar shkollimin e mesëm nxënësit i mundësohen këto afate:
 - 1.1 qershor, gusht, nëntor 2009
 - 1.2 janar, prill, qershor, gusht, nëntor 2010
 - 1.3 janar 2011.

Neni 5
Nxënësit e shkollës profesionale

1. Nxënësi i shkollës së mesme profesionale duhet t`i nënshtrohet praktikës profesionale për vitin e fundit respektivisht për provimin e diplomës.

Neni 6
Lirimi nga praktika profesionale

1. Nxënësi i cili e ushtron profesionin në vendin e punës është i liruar nga praktika profesionale.
2. Nxënësi duhet të sjellë dëshmi se është në marrëdhënie pune dhe vlerësimin nga punëdhënësi për aftësinë e tij në profesion.

Neni 7
Pagesa

1. Nxënësi duhet ta bëjë pagesën në xhirollogarinë e shkollës në bazë të rregullores së shkollës.

Neni 8
Dokumentet e nevojshme

1. Nxënësi për t'iu nënshtuar provimeve duhet të paraqes këto dokumente:
- 1.1 Kërkesën e cila merret në shkollë,
 - 1.2 Dëftesat për klasët 1, 2, 3 respektivisht 4,
 - 1.3 Certifikatën e lindjes,
 - 1.4 Dëshminë e pagesës dhe
 - 1.5 Dëshminë për marrëdhënie pune për ata të cilët e ushtrojnë profesionin e vet.

Neni 9
Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrje në fuqi të këtij Udhëzimi shfuqizohet Udhëzimi administrativ nr. 5/2008 dt. 18.03.2008.

10
Hyrja në fuqi

1. Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.


Enver Hoxhaj, ministër